

NEWSLETTER

Tetor

Albsig fushatë sensibilizuese për Tetorin Rozë: Kujdesi për shëndetin fillon me Ty!

Apeli i Albsig për gratë dhe vajzat në Tetorin Rozë: Kujdesi për veten, Kujdes për Jetën.

Albsig dhe Qendra për Edukim Kulinar: Një Ditë Gatimi Plot Dashuri për Fëmijët në Nevojë.

Ja sa gra dhe vajza janë prekur nga kanceri i gjirit për vitin 2023 dhe disa këshilla nga Albsig për kujdesin ndaj kësaj sëmundjeje, jo vetëm në kuadër të Tetorit Rozë.

Albsig dhe Kastrati Construction ofrojnë vizita falas për gratë dhe vajzat e stafit në kuadër të Tetorit Rozë në Turkish Hospital.



PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP





Albsig fushatë sensibilizuese për Tetorin Rozë: Kujdesi për shëndetin fillon me Ty!

Tetori është muaji i ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit të gjirit. Për Tetorin Rozë, nga sot e deri në datë 31, Albsig zhvillon një fushatë ndërgjegjësimi me moton: Në ndihmë të vajzave dhe grave për diagnostifikimin sa më të hershëm të cdo problematike shëndetësore fokusuar në kancerin e gjirit. Muaji tetor, është një muaj me një mesazh të fortë dhe shumë të rëndësishëm për të sensibilizuar sa më shumë vajza dhe gra për kancerin e gjirit. Një muaj që i dedikohet kontrolleve dhe informacioneve për kapjen në kohë dhe parandalimin e kancerit të gjirit, një kontroll që duhet kryer nga të gjitha vajzat dhe gratë në mënyrë periodike, çdo vit. Në shenjë sensibilizimi, me këtë mesazh është bashkuar edhe Albsig, pjesë e Kastrati Group. Numërohen qindra fushata sensibilizuese dhe mesazhe të shumta që Albsig ka organizuar në kuadër të sensibilizimit të grave dhe vajzave në luftë kundër kancerit të gjirit. Tashmë, siç edhe dihet që Tetori Rozë është muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, dhe Albsig është dhe do të jetë përkrah çdo gruaje në këtë betejë të rëndësishme. Shëndeti është pasuria më e çmuar dhe kujdesi për veten është hapi i parë drejt një të ardhmeje të sigurtë. Ne në Albsig, besojmë se siguria shkon përtej aseteve dhe pronave, ajo fillon me shëndetin. Për këtë arsye, ju inkurajojmë që gjatë këtij muaji të merrni kohën për të bërë kontrollin e gjirit. **Zbulimi i hershëm shpëton jetë!**

Albsig gjithmonë përkrah grave dhe vajzave, jo vetëm në tetor!

Gjatë gjithë Tetorit Rozë, Albsig do të ofrojë paketa të dedikuara për shëndetin e grave dhe të vajzave, duke përfshirë mbulimin për mamografite dhe ekzaminimet e rregullta. Kontrolli i gjirit përmes mamografisë dhe ekzaminimeve të tjera rutinë është metoda më efikase për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Sa më shpejtë të diagnostifikohet, aq më të mëdha janë mundësitë për një trajnim të suksesshëm dhe shërim të plotë. Me Albsig do të keni jo vetëm një sigurim të besueshëm, por edhe një partner që ju mbështet në çdo hap për një jetë më të sigurtë dhe më të shëndetshme. Të kujdesesh për veten është akti më i fuqishëm që mund të bësh. **“Sigurohu sot dhe bëhu pjesë e një fushate që fuqizon dhe mbështet çdo grua në luftën për shëndetin. Albsig, kujdes për shëndetin, kujdes për ty!”**, është kjo thirrja e herëpashershme që ju bën Albsig vajzave dhe grave në lidhje me diagnostifikimin e hershëm të kësaj sëmundjeje.

Apeli i Albsig: Bëj vetëkontrollin e vetvetes. Ndiq hapat si më poshtë:

- 1 **Kryej vetëkontroll** një herë në muaj zakonisht një javë pas menstruacioneve, për të vëzhguar çdo ndryshim në formën apo djersitjen e gjirit.
- 2 **Vizita tek mjeku** i fushës për të bërë ekzaminimet personale çdo vit. Për vajzat dhe gratë që janë në moshën 40 vjeçare është e rëndësishme të bëhet mamografia çdo dy vjet ose më shpesh sipas rekomandimeve të mjekut specialist.
- 3 **Çdo vonesë në kohë përkthehet në dëm shëndetësor.** Çdo ditë është shumë e rëndësishme për gjithësecilin prej nesh prandaj mos e lini për nesër kontrollin e mjekut që mund ta bëni lirisht sot. Kujdesi ndaj vetes është fuqizim. Bëje kontrollin e gjirit pjesë të rutinës tënde vjetore dhe inkurajo edhe gratë e tjera për të bërë të njëjtën gjë. Bashkohu me fushatën Tetorit Rozë në Albsig, dhe bëje zbulimin e hershëm një prioritet. Albsig me ju dhe për ju në çdo hap të rëndësishëm jetësor.



Apeli i Albsig për gratë dhe vajzat në Tetorin Rozë: Kujdesi për veten, Kujdes për Jetën.

Tetori Rozë është një muaj i veçantë, i dedikuar ndërgjegjësimit dhe edukimit për kancerin e gjirit, një nga sëmundjet më të përhapura dhe më të rrezikshme për gratë dhe vajzat në mbarë botën. Albsig i ka qëndruar dhe i qëndron përkrah çdo gruaje në këtë rrugëtim të rëndësishëm për parandalimin dhe trajtim të hershëm. Kujdesi ndaj shëndetit është zgjidhja më e rëndësishme që mund të bësh për veten dhe të dashurit e tu. Kanceri i gjirit është i shërueshëm, por sekret i qëndron te diagnostikimi i hershëm i tij. Teksa Tetori Rozë na kujton rëndësinë e kontrolleve të rregullta, Albsig ju inkurajon të merrni masat që të shpëtojnë jetën. Albsig është këtu për të mbështetur çdo hap tëndin drejt shëndetit më të mirë. Ne ofrojmë paketa sigurimi të personalizuar për gratë dhe vajzat që përfshijnë dhe mundësinë e ekzaminimeve mjekësore dhe mamografinë. Në këtë mënyrë çdo grua mund të ndjehet e siguruar, jo vetëm për të tashmen por edhe për të ardhmen e saj.

Albsig gjithmonë përkrah grave dhe vajzave, jo vetëm në tetor!

Sigurimi nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e asetevemateriale, por edhe me atë më të çmuarën si është jeta dhe shëndeti. Tetori rozë është një mundësi e mirë për të ndërmarrë një hap drejt një kujdesi më të plotë për veten dhe për të gjithë pjesëtarët e familjes. Ne besojmë se çdo grua **meriton** të ndjehet e sigurtë dhe e mbështetur në çdo moment të jetës së saj. Prandaj gjatë këtij muaji, Albsig inkurajon gjithësecilën prej nesh të kryejë kontrollet e nevojshme mjekësore dhe të sigurojë çdo rrugë drejt një shëndeti më të fortë dhe të qëndrueshëm. Me një gamë të gjerë produktesh dhe paketash të personalizuar për vajzat dhe grate, Albsig është një ndër kompanitë e sigurimeve që edukon dhe ndërgjegjëson brezin e ri përsa i përket rëndësisë së sigurimit të shëndetit.

Thirrja e Albsig: Bëhu zëri i ndryshimit!

Ndaje këtë mesazh me miqtë dhe mikeshat Tuaja. Bashkohu me Albsig në përpjekjet Tuaja për të shpëtuar jetë dhe për të fuqizuar çdo grua në luftën për shëndet dhe mirëqenie. Albsig, siguria fillon me kujdesin për vetveten! Bëhu e informuar, bëhu e fuqizuar. Vepro, kontrollo, parandalo. Zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit shpëton jetë. Duke kryer kontrolle të rregullta, vetëkontrolle të gjirit dhe mamografinë kur është e nevojshme, ti merr kontrollin mbi shëndetin tënd.

Mos prit – koha për veprim është tani! Bëhu zëri i vetvetes dhe kujdesu për shëndetin tënd, sot për një të nesërme më të sigurtë për ty dhe familjen tënde. Sepse kujdesi për veten është fuqia më e madhe që ke.

Ja sa gra dhe vajza janë prekur nga kanceri i gjirit për vitin 2023 dhe disa këshilla nga Albsig për kujdesin ndaj kësaj sëmundjeje, jo vetëm në kuadër të Tetorit Rozë.



Kanceri i gjirit është një nga sëmundjet më të përhapura mes grave në të gjithë botën, por diagnostikimi i hershëm mund të jetë vendimtar për trajtimin e suksesshëm. Vlen të theksohet se vetëm në Shqipëri 73% e të prekurave nga kanceri i gjirit kanë mbijetuar, ku vitin e fundit nga kjo sëmundje janë prekur edhe 15 meshkuj. Shqipëria mbetet vend me risk të ulët krahasuar me vendet e rajonit përsa i përket kancerit të gjirit, por shpeshtësia e rasteve të reja po rritet nga viti në vit.

“Në vitin 2023, u diagnostikuan 744 femra me kancer të gjirit në të gjithë vendin ose 61.4 për 100,000 femra. Në 2023–shin u diagnostikuan gjithashtu edhe 15 kancere gjiri te meshkujt. Mbetemi vend me risk të ulët, por rastet e reja kanë ardhur në shtim çdo vit. Ajo që duhet theksuar është se kanceri i gjirit është i kontrollueshëm, por mbetet kanceri më i rëndësishëm në Shqipëri për nga numri i lartë i rasteve dhe për nga kostot e larta financiare të trajtimit”, u shpreh për mediat Eksperti i Programit Kombëtar të Kontrollit të Kancerit në Shqipëri, z.Alban Ylli.

Rastet e reja me kancer gjiri te femrat sipas grup-moshave për periudhën 2015-2023

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
0-29	6	10	9	6	3	6	6	6	2
30-39	57	47	50	54	50	55	58	54	56
40-49	155	161	187	165	144	120	137	130	131
50-59	231	242	241	236	232	181	201	237	217
60-69	150	177	170	178	204	204	208	184	226
70+	54	61	56	69	86	62	104	99	112
Total	653	698	713	708	719	628	714	710	744

Ndërkaq thuhet se rreth 204 gra humbën jetën nga ky kancer gjatë vitit të fundit por të dhënat tregojnë se vdekshmëria është frenuar dukshëm vetëm falë diagnozës së hershme. **“Mbijetesa nga ky kancer ka shkuar në 73% ndryshe nga çfarë ka qenë disa vite më parë që shkonte në rreth 65%”,** theksoi fuqishëm z. Ylli. Ai shtoi se moshë mesatare e diagnostikuar ndjek moshën mesatare të popullatës shqiptare.

“Moshë mesatare e grave dhe vajzave të diagnostikuara me këtë sëmundje është 59 vjeç dhe kjo ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Por të dhënat tregojnë se kemi edhe raste tek të 20-tat. Më shumë se 75 përqind e rasteve të reja në vitin 2023 (73% në vitin 2022) janë diagnostikuar mbi moshën 50 vjeç. Edhe në këtë rast vërehet një rritje e proporcionit të rasteve të diagnostikuara mbi moshën 50 vjeç, me kalimin e viteve”, vijon më tej Ylli. Por ndërsa mjekët bëjnë thirrje për mamografi pas të 40-ve dhe një herë në dy vitë pas të 50-tave, ende ka indiferentizëm. **“Nga bisedat me gratë shohim se ka ende stigëm për t’u diagnostikuar dhe shpesh konstatojmë mendësinë se nuk më bën gjë ky kancer. Mamografia shpëton jetë. Është i rekomandueshëm që tek të 40-tat ndërsa tek mbi moshën 50 vjeç duhet të futet në kontroll rutine çdo dy vite”,** bën thirrje z. Ylli.

Albsig, duke qenë pranë komunitetit dhe shëndetit tuaj, ju sjell disa këshilla të rëndësishme për të ndihmuar në parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit.

Vetëkontrolli i gjirit

Njohja e trupit tuaj është hapi i parë drejt shëndetit të mirë. Vetëkontrolli i gjirit rekomandohet të bëhet çdo muaj veçanërisht pas ciklit menstrual, për të vërejtur çdo ndryshim në formë madhësi ose ndonjë masë të pazakontë.

Mamografia

Për gratë mbi moshën 40 vjeç, mamografia është një test thelbësor për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Bëni kontrole të rregullta një herë në vit ose sipas rekomandimeve të mjekut tuaj.

Stili i jetesës së shëndetshme

Ushqimi i balancuar, aktivitet fizik i rregullt dhe shmangia e konsumit të alkoolit dhe duhanit mund të ndihmojë dukshëm në reduktimin e rrezikut për zhvillimin e kancerit të gjirit. Hani shumë fruta dhe perime, dhe përpiquni të mbani një peshë të shëndetshme.

Histori familjare

Nëse keni një histori familjare të kancerit të gjirit është e rëndësishme të diskutoni me mjekun për testet dhe analizat gjenetike që mund të jenë të nevojshme. Kjo ndihmon në vlerësimin e rrezikut tuaj dhe marrjen e masave të duhura.

Vizitat e rregullta te mjeku

Kontrollet e rregullta mjekësore janë një tjetër aspekt i rëndësishëm për parandalimin e kancerit të gjirit. Nëse vini re ndryshime në trupin tuaj ose keni simptoma të pazakonta, kontaktoni menjëherë mjekun për një kontroll të plotë.



Përkujdesje ndaj shëndetit mendor

Diagnoza ose frika nga kanceri mund të jetë stresuese. Albsig këshillon të kërkon ndihmë nga specialistët e shëndetit mendor ose grupet e mbështetjes për t'u përballur me ankthin dhe stresin që mund të shoqërojë shqetësimet shëndetësore. Duke ndjekur këto hapa të thjeshta, ju mund të mbani shëndetin tuaj nën kontroll dhe të kontribuoni në zbulimin e hershëm të çdo problemi të mundshëm. Albsig është këtu për tju ndihmuar me sigurimet më të mira shëndetësore, duke ju ofruar mbështetje për të jetuar një jetë të shëndetshme dhe të sigurtë.



Sigurim shëndeti në Albsig

Sigurimi nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e aseteve materiale, por edhe me atë më të çmuarën siç është shëndeti dhe jeta. Tetori Rozë është një mundësi e mirë për të ndërmarrë një hap drejt një kujdesi më të plotë për veten dhe për të gjithë pjestarët e familjes. Ne besojmë se çdo grua meriton të ndjehet e sigurtë dhe e mbështetur në çdo moment të jetës së saj. Prandaj gjatë këtij muaji, Albsig inkurajon gjithësecilën prej nesh të kryejë kontrollet e nevojshme mjekësore dhe të sigurojë çdo rrugë drejt një shëndeti më të fortë dhe të qëndrueshëm. Me një gamë të gjerë produktesh dhe paketash të personalizuar për vajzat dhe gratë, Albsig është një ndër kompanitë e sigurimeve që edukon dhe ndërgjegjëson brezin e ri përsa i përket rëndësisë së sigurimit të shëndetit.



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP



Albsig dhe Qendra për Edukim Kulinar: Një Ditë Gatimi Plot Dashuri për Fëmijët në Nevojë.

Albsig organizoi një aktivitet të veçantë bamirësie në bashkëpunim me Qendrën për Edukim Kulinar (QEK), me qëllim mbështetjen e fëmijëve në nevojë përmes gatimit të ushqimeve të shëndetshme dhe të shijshme për të gjitha moshat. Ky aktivitet u mirëprit nga stafi i Albsig, ku morën pjesë 11 punonjës të cilët jo vetëm kontribuan me kohën dhe energjinë e tyre pozitive, por edhe krijuan një atmosferë të ngrohtë dhe të gëzueshme në ambientet e kuzhinës.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ofrimi i vakteve të shëndetshme për fëmijët që ndodhen në situata të vështira ekonomike dhe sociale. Gatimi i përbashkët u kthye në një eksperiencë bashkëpunimi dhe kreativiteti, ku punonjësit e Albsig jo vetëm treguan aftësitë e tyre në kuzhinë, por u angazhuan për të ofruar ushqime të shijshme dhe të servitura me përkujdesje.

Një nga aspektet më të bukura të këtij aktiviteti ishte ndërveprimi i stafit të Albsig me profesionistët e kulinarisë, duke mësuar teknika të reja gatimi dhe duke përfituar nga përvoja edukative që ofron kjo qendër. Ky event ishte një mundësi për të kombinuar përgjegjësinë sociale të Albsig me ndihmën direkte për komunitetin, duke rritur frymën e bashkëpunimit brenda ekipit.




Partneri juaj i sigurtë!

Përkushtimi i Albsig ndaj shoqërisë.

Për Albsig, përgjegjësia sociale nuk është thjesht një detyrim korporativ, por një mision i rrënjosur thellë në vlerat e kompanisë. Aktiviteti i fundit, organizuar në bashkëpunim me QEK, ishte një iniciativë për të ofruar vakte të ngrohta për fëmijët në nevojë dhe për të krijuar një ndjenjë të veçantë kënaqësie për punonjësit që morën pjesë.

Një hap përpara në ndikimin social.

Ky aktivitet është pjesë e strategjisë së përgjegjësisë sociale që Albsig ka ndërmarrë për të bërë ndryshime pozitive në shoqëri. Përmes partneriteteve dhe nismave të ndryshme që mbështesin grupet më të ndjeshme, Albsig tregon se mbështetja e komunitetit është një prioritet i rëndësishëm. Duke vendosur një standard të lartë për Përgjegjësinë Sociale në sektorin e sigurimeve, Albsig synon të vazhdojë me organizime të tjera bamirësie dhe sociale, për të ndihmuar jo vetëm fëmijët, por edhe komunitetet e prekura nga varfëria apo sfida të tjera sociale. Me përkushtim dhe angazhim, Albsig vazhdon të kontribuojë në përmirësimin e jetës së njerëzve në nevojë.





Albsig dhe Kastrati Construction ofrojnë vizita falas për gratë dhe vajzat e stafit në kuadër të Tetorit Rozë në Turkish Hospital.

Tetori në Albsig hap siparin rozë me simbolikat e këtij muaji. Që në hyrje të zyrave qendrore të shoqërisë së Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, të pret një baner dhe një glob qelqi i mbushur me fjongot rozë, simbolika e këtij muaji. Dhe jo vetëm kaq, por çdo punonjëse dhe çdo klient këtë muaj në Albsig respekton simbolikën që fjongoja rozë mbart. Në kuadër të Tetorit Rozë, muajit të ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit të gjirit, Albsig dhe Kastrati Construction kanë marrë përsipër një nismë të rëndësishme për të mbështetur vajzat dhe gratë, duke organizuar vizita mjekësore falas për të gjitha koleget femra përfshirë dhe ato të kompanive të tjera të Kastrati Group. Ndryshe nga vitet e tjera, këtë tetor në këtë iniciativë kaq të rëndësishme dhe domethënëse, nismës së përvitshme të Albsig i është bashkuar dhe Kastrati Construction me të gjithë stafin përkatës. Për dy kompanitë e Kastrati Group, duket se ky bashkëpunim është bërë dhe do të bëhet thuajse në çdo vit në kuadër të mirëqenies së punonjëseve, i cili është realizuar në partneritet me Turkish Hospital, një nga spitalet më të njohura dhe më të avancuara në vend.

Pse Tetori Rozë është i rëndësishëm për Ne!?

Tetori është i njohur ndërkombëtarisht si muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, një iniciativë që synon të rrisë vetëdijen mbi këtë sëmundje dhe të nxisë kontrollet e rregullta për diagnostikim të hershëm. Tetori rozë është i rëndësishëm për Albsig sepse lidhet drejtpërdrejt me ndërgjegjësimin për luftën kundër kancerit të gjirit, një çështje e ndjeshme për të cilën Albsig mund të tregojë mbështetje përmes produkteve dhe shërbimeve të saj. Ndërgjegjësimi i përqendruar gjatë tetorit ndihmon në promovimin e rëndësisë së kontrolleve shëndetësore, veçanërisht për gratë, dhe mund të përforcojë rëndësinë e produkteve si ai që përfshin kontrollin bazë dhe ekzaminimin e gjirit, që po punon për Albsig. Ky muaj ofron një mundësi të rëndësishme për kompaninë Albsig sepse e bën të mundur të vejë theksin dhe të llojë ndjeshëm mbi kujdesin dhe përgjegjësinë shoqërore. Kanceri i gjirit mbetet një nga sëmundjet më të përhapura tek femrat, por zbulimi në fazat e hershme rrit ndjeshëm shanset për shërim. Në këtë kuadër, Albsig dhe Kastrati Construction vazhdojnë traditën e tyre të përvitshme për të kontribuar në këtë kauzë të rëndësishme, duke ofruar një mundësi konkrete për gratë dhe vajzat e stafit që të kujdesen për shëndetin e tyre. Bazuar në historikun e kompanisë Albsig tashmë, e ka kthyer në traditë mirëqenien e shëndetit të punonjëseve.



Çfarë përfshin kjo nismë?

Falë bashkëpunimit me Turkish Hospital, të gjitha koleget femra (gra dhe vajza) të Albsig dhe Kastrati Construction do të kenë akses në kontrolle mjekësore të plota, falas, për të parandaluar dhe zbuluar çdo shenjë të hershme të kancerit të gjirit.

Në këtë kuadër, ofrohen:

- **Ekzaminime të detajuara mjekësore**, përfshirë ekografitë për të diagnostikuar ndonjë problem të mundshëm në gjendrat e gjirit.
- **Konsultime me specialistë të fushës**, për të marrë këshilla dhe udhëzime mbi kujdesin dhe mbrojtjen nga kanceri i gjirit.
- **Këshillime të personalizuar** mbi shëndetin e përgjithshëm të grave, që përfshijnë informacion mbi mënyrat më të mira për një jetë të shëndetshme dhe të balancuar.

Ndikimi i kësaj iniciative në mirëqenien e stafit.

Shëndeti i stafit është një përparësi për Albsig, dhe kjo iniciativë përforcon përkushtimin e kompanisë për të ofruar jo vetëm siguri financiare përmes produkteve të sigurimeve, por edhe mbështetje reale për mirëqenien fizike dhe mendore të punonjësve. Kujdesi për shëndetin e grave është një investim i rëndësishëm për mirëqenien afatgjatë të stafit dhe i jep një mesazh të qartë komunitetit të biznesit: mirëqenia e stafit është baza për suksesin e çdo kompanie.

Përfitimet për punonjësit.

Punonjëset e Albsig dhe partnerët e saj janë inkurajuar të përfitojnë nga kjo mundësi e rëndësishme. Kontrollat falas në Turkish Hospital përfaqësojnë jo vetëm një shërbim me vlerë financiare, por edhe një siguri dhe qetësi mendore për të gjitha gratë që kujdesi për shëndetin e tyre është një prioritet. Vizitat do të realizohen gjatë muajit tetor, duke i mundësuar secilës punonjëse të gjejë kohën e përshtatshme për t'u kontrolluar. Ky është një shembull i fuqishëm i përgjegjësisë sociale që ndërmarrjet si Albsig dhe Kastrati Construction tregojnë ndaj stafit të tyre. Iniciativa e Tetorit Rozë mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien e stafit të Albsig dhe Kastrati Construction, duke zgjeruar ndjeshëm ndërgjegjësimin për shëndetin dhe kujdesin personal në mjedisin e punës.



Përmes produkteve dhe shërbimeve Albsig bën rritjen e ndërgjegjësimit shëndetësor. Si dhe promovimin e kontrolleve të rregullta shëndetësore, si ekzaminimet për kancerin e gjirit, inkurajon stafin të bëjë kujdes të vazhdueshëm për shëndetin e tyre, duke parandaluar sëmundjet në faza të hershme.

Jo vetëm kaq por, duke u fokusuar në shëndetin e grave, iniciativa përmirëson ndjesinë e mbështetjes së kompanisë ndaj stafit të saj, veçanërisht për gratë, duke ndikuar pozitivisht në moralin dhe produktivitetin. Albsig, duke qenë lider në sigurimet vullnetare përfshirë këtu sigurimin e shëndetit ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e kulturës së kujdesit për punonjësit. Ky kujdes është reflektuar përmes produkteve të sigurimit të shëndetit të dedikuara.

Rëndësia e zbulimit të hershëm.

Zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit ka treguar që rrit ndjeshëm shanset për trajtim të suksesshëm. Me përkushtimin për të ofruar këto shërbime falas, Albsig dhe Turkish Hospital synojnë jo vetëm të përmirësojnë jetën e grave, por edhe të japin një shembull të fortë se si një ndërmarrje mund të kontribuojë në luftën kundër sëmundjeve të rënda.

Angazhimi afatgjatë i Albsig për shëndetin.

Kjo nismë nuk është një rast sporadik, por pjesë e një strategjie më të gjerë të Albsig për të përmirësuar mirëqenien e stafit të saj. Vizitat falas për stafin gjatë Tetorit Rozë janë një tregues i qartë i përkushtimit të vazhdueshëm të kompanisë për të mbështetur shëndetin dhe jetën e çdo punonjësi. Kjo iniciativë do të vazhdojë të promovohet dhe të mbështetet edhe në vitet e ardhshme, duke krijuar një model për kujdesin e qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm ndaj stafit.

Në përputhje me misionin e saj për të qenë gjithmonë pranë punonjësve dhe për të promovuar shëndetin dhe mirëqenien e tyre, Albsig përmes bashkëpunimit me Turkish Hospital kanë sjellë një mundësi të vyer për stafin e kompanisë. Me nisma të tilla, siguria dhe kujdesi për jetën bëhen realitet, duke përforcuar përkushtimin për të bërë ndryshim pozitiv për punonjësit dhe komunitetin.



PJESË E  KASTRATI GROUP



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL